



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

**Autoritet Menaxhues : Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

**Udhëzim për aplikantët**

**INSTRUMENTI FINANCIAR: PROGRAMI INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE**

Afati për dërgimin e aplikimit: 28.01.2019

Per tu njohur me kriteret e aplikimit, formatin e aplikimit dhe dokumentacionin plotësues/sqarues, lutem referohuni faqes sonë web <https://www.albaniandf.org/>. Gjithashtu ju mund të kontaktoni me adresën [sekretariati@albaniandf.org](mailto:sekretariati@albaniandf.org) per cdo pyetje e sqarim lidhur me aplikimin gjate kohezgjatjes se shpalljes se thirrjes per aplikime por jo me vonë se 5 ditë para afatit të mbylljes së thirrjes.

## **PROGRAMI “INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE”**

### **1.1.HYRJE**

Ky udhëzim është në funksion të aplikantëve potencialë të Thirrjes për projekte për vitin 2019 për programin “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Programi “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale” synon inkurajimin e rajoneve (territoreve) për të gjeneruar zhvillim, duke vënë në përdorim burimet e tyre dhe duke konkurruar midis tyre. Ky instrument është parashikuar të zbatohet përmes thirrjeve për projekte, për të siguruar trajtim të barabartë dhe konkurrence të hapur mes aplikanteve.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit në aneksin nr.3 të ligjit të buxhetit nr. 99/2018 datë 3.12.2018, “Për buxhetin e vitit 2019” është përcaktuar të jetë Autoriteti Menxhues i këtij programi dhe ka miratuar në datë 06.12.2018 me vendim të Bordit Drejtues nr.171 Prot., rregullat dhe kriteret e aplikimit për këtë thirrje për projekte. Gjithashtu, Bordi Drejtues i FSHZH do të miratojë listën e projekteve fituese.

Fondi i angazhuar në këtë thirrje do të jete 2,500,000,000 (dy miliard e pesëqind milion) lekë.

Aplikantë sipas Aneksit 3 të ligjit të buxhetit për vitin 2019 do të jenë të gjitha Njesitë e VetëQeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në Ligjin për Reformën Territoriale.

Thirrja hapet në datë 28.12.2018 dhe mbyllet në datë 28.01.2019. Të gjitha aplikimet që vijnë pas këtij afati do të skualifikohen.

Kjo thirrje mbështetet në bazën ligjore si më poshtë:

-Ligj nr. 99/2018 datë 3.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Aneksi nr.3 i këtij ligji;

- Neni 100 i Kushtetutës;

Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bordi Drejtues i tij, do të mbështetet nga një strukturë e posaçme e ngritur pranë FSHZH-së për të gjithë procesin e administrimit të thirrjeve për projekte. Kjo strukturë ka si detyrë të mbështesë dhe këshillojë aplikantët gjatë thirrjes për projekte, të mbështesë procesin e vlerësimit, informimit, monitorimit dhe raportimit.

### **1.2.OBJEKTIVAT E THIRRJES PËR PROJEKTE**

Objektivi i kësaj thirrje do të jete nxitja e zhvillimit social-ekonomik përmes projekteve të infrastrukturës rajonale me fokus përmirësimin e turizmit, aksesueshmërinë mes komuniteteve dhe drejt shërbimeve bazë, duke inkurajuar bashkëpunimin mes njesive vendore.

Kjo thirrje do të ketë dy drejtime kryesore:

A: Projekte të Zhvillimit Rajonal, të fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore lidhese mes njesive vendore që adresojnë një nevojë të zhvillimit social-ekonomik rajonal me qëllim lehtësimin e aksesit të komuniteteve drejt shërbimeve bazë, tregut dhe vendeve me potencial të lartë turistik, natyror dhe kulturor;

B: Projekte që shërbejnë si katalizator i rivitalizimit urban dhe rural, përmes jetëzimit të hapsirave publike e të ekonomive lokale, përmirësimit të aksesit dhe të lëvizshmërisë, rivitalizimit të poliçendrave urbane dhe përmirësimit të infrastrukturës vendore.

**Cdo projekt duhet të mbështetet në një nga drejtimet e mësipërme dhe objektivat specifike, përndryshe aplikimi do të refuzohet.**

Aplikanteve u kërkohet në cdo rast, gjatë zhvillimit të projektit, të respektojnë edhe çështjet sa më poshtë:

-Barazia gjinore, me qëllim respektimin e të drejtave, detyrimeve dhe mundësive të gjithë gjinive;

-Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve dhe grupeve vunerabël;

-Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e burimeve natyrore dhe biodiversitetit;

### **1.3.FINANCIMI**

Shuma totale e angazhuar në këtë thirrje është 2,500,000,000 Lekë. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejten e mos kontraktimit të të gjithë shumës.

Nga çdo NJQV numri maksimal i projekteve që duhet të aplikojnë janë tre në total, duke i renditur ato sipas prioritetit të institucionit.

Projektet do të financohen në shumën 100% nga IVR. Në këtë thirrje nuk kërkohet bashkëfinancim nga burimet e aplikanteve.

### **1.4. RREGULLAT E THIRRJES**

#### **1.4.1. Ligjshmëria e aplikanteve**

Në këtë thirrje mund të aplikojnë të gjitha njesitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 115/2014 “ Për ndarjen administrative-territoriale të njesive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” .

Inkurajohet aplikimi i përbashkët mes dy apo më shumë njesive për projekte me karakter të zhvillimit rajonal. Në këtë rast aplikimi dorëzohet nga njëri nga aplikantët, në marrëveshje mes palëve.

#### **1.4.2. Ligjshmeria e projekteve**

Projektet duhet të zbatohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Projektet duhet të jenë të mbështetura në një nga drejtimet e thirrjes për projekte, përndryshe aplikimi do të refuzohet.

#### **1.4.3. Procedurat e aplikimit**

Për të aplikuar në këtë thirrje, aplikantët duhet të ndjekin hapat si më poshtë:

- Plotësimin e formatit të projekt fishes sipas shtojcës nr.1 të këtij udhëzimi që do të shërbej si përmbledhëse e gjithë informacionit kryesor të projektit;

Do të njihen vetem aplikimet e derguara nga kryetarët e qeverisjes vendore ose drejtues të tjerë në bashki të autorizuar nga Kryetari për të ndjekur procedurën e aplikimit ( Në këtë rast dërgohet paraprakisht lajmërimi nga Kryetari i Bashkisë në adresën elektronike).

Aplikantët mund të dërgojnë pyetje apo kërkesa për sqarime jo më vonë se 5 ditë para mbylljes së afatit të aplikimit, në adresën: [sekretariati@albaniandf.org](mailto:sekretariati@albaniandf.org)

### 1.5.KALENDARI I THIRRJES

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Dërgim i shkresës Zyrtare pranë NJQV-ve dhe paraqitje në faqen zyrtare të FSHZH-se	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes së programit IVR.
30 ditë kalendarike nga dërgimi i shkresës zyrtare	Aplikuesit sipas aneksit 3 te ligjit të buxhetit	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit me shkresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit
15 ditë kalendarike nga mbyllja e aplikimit	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas pikë 1.6 të këtij udhëzimi.
		FSHZH paraqet zyrtarisht pranë Këshillit Drejtues së FSHZH-së listën e projekteve që propozohen për financim.

## **1.6. KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE QË PROPOZOHEN PËR FINANCIM**

Këto kritere përdoren nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë, i një projekti që propozohet për financim/miratim nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kriteret për vlerësimin e projekteve të shortlistuara janë, si më poshtë vijon:

1. Plotësia dhe saktësia e dokumentacionit të dorëzuar. Argumentimi i projekt-propozimit, detajimi teknik, kostimi, plotësimi i fishave. Ky kriter nënkupton se projektet që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë me grafik punimesh të detajuar, si dhe ato projekte, ku kostimi i tyre dhe preventivi janë përpiluar e vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen si koherente për financim: ky kriter vlerësohet me **0 deri në maksimalisht 30 pikë**;
2. Shkalla e përputhshmërisë së projekt-propozimeve me drejtimin e thirrjes dhe dokumenta strategjike(pl.vendore etj): ky kriter vlerësohet me **0 deri në maksimalisht 30 pikë**;
3. Ndikimi i projektit në zhvillimin e ekonomisë, turizmit dhe cilësinë e jetës së banorëve, parë nga ana e përfituesit, qytetarit: ky kriter vlerësohet me **0 deri në maksimalisht 20 pikë**;
4. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti ose zona kryesore dhe dytësore e ndikimit/mbulimit të shërbimit prej tij. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë: ky kriter vlerësohet me **0 deri në maksimalisht 20 pikë**;

## Shtojcë I: FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

### Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	Institucioni
Data e aplikimit (*)	Data e dergimit nga institucioni
Titulli i projektit (*)	Titulli i projektit të jetë i njëjtë me titullin që specifikohet në kërkesën e depozituar pranë sekretariatit teknik.
Data e fillimit të projektit (*)	Të paraqitet grafiku i zbatimit të punimeve të projektit, për të qartësuar shtrirjen kohore të tij.
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbluar informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: <ul style="list-style-type: none"><li>- Vendndodhja e objektit të investimit; specifikuar në hartë ku është sqaruar qartë kufiri i ndërhyrjes;</li><li>- Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt;</li><li>- Përshkrimi i detajuar i punimeve/ndërhyrjeve që do të kryhen;</li><li>- Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij;</li><li>- Risqet për zbatimin e tij;</li><li>- Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse aplikohet), si edhe dokumentacioni përkatës.</li></ul>
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfitojnë drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesish.
Sipërfaqe e trajtuar (*)	Të specifikohet sa është sipërfaqja e përgjithshme në të cilën ndërhyrja projektit dhe nëse zhvillohet me faza apo lote.
Rendi prioritar (*)	NJQV-të mund të aplikojnë me maksimumi 3 projekte. Në këtë rast renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje /lidhjes me drejtimet e thirrjes (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: <ul style="list-style-type: none"><li>- Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij;</li><li>- Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen;</li><li>- Të specifikohet periudha në vite për kostot e mirëmbajtjes.</li></ul>
Kostoja totale e projektit (*)	Kostoja totale e projektit të jepet me TVSH.
Dokumentet teknike (*)	Dosja e aplikimit përmban: <ul style="list-style-type: none"><li>- projektin teknik/projektin e zbatimit;</li><li>- preventivin;</li><li>- relacionin teknik;</li><li>- specifikimet teknike;</li><li>- CD;</li><li>- përlllogaritjet/parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit.</li><li>- Vleresimin e ndikimit në mjedis;</li><li>- Planin e shpronësimeve (dosjen, përlllogaritje e kostos)</li></ul>